Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

Numër: 01/398
Datë:20.06.2024

Në mbështetje të neneve 8, 9 dhe 16 të Ligjit Nr. 03/L-060 për Kualifikimet Kombëtare, të Udhëzimit Administrativ (MASHT) Nr. 35/2014 për Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë, nenit 5 paragrafi 4, 5 dhe 6 si dhe nenit 6 paragrafi 1 të Rregullores Nr. 01/196 e punës e Këshillit Drejtues të Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve, Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve (AKK), në mbledhjen e mbajtur me datë 13.06.2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

1. **Riakreditohet dhe rivalidohet** Instituti për Aftësim Profesional dhe Përkrahje të Punësimit "DITURIA" me adresë: Rr. "Rezistenca e Vërrinit, p.n, Prizren, Republika e Kosovës, për periudhën tre (3) vjeçare, përkatësisht nga data 28.03.2024 deri 27.03.2027, me kualifikimin e aprovuar në Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve (KKK):

   1.1. **Murator dhe punëtorët e ngjashëm**, Niveli III i KKK, lloji: Kualifikimet kombëtare profesionale (E), me 15 kredi të AAP, për ofrim, vlerësim dhe certifikim të moduleve:

   - Moduli 1- Bazat e ndertimtarisë dhe mbrojtja në punë, me 240rë/2 kredi të AAP;
   - Moduli 2-Leximi, aplikimi dhe matjet teknike, me 36 orë/ 2 kredi të AAP;
   - Moduli 4- Muratim me blloqe, tulla dhe elemente tjera, me 204 orë/ 8 kredi të AAP;
   - Moduli 5- Muret ndarëse nga rigipsi, 66 orë /3 kredi të AAP.

2. Institucioni mund të realizojë procesin e trajnimit me shtatë (7) grupe brenda vitit, me gjithsej 84 kandidat brenda vitit, numri i kandidatëve për një grup mund të jetë maksimalisht gjashtë (6) brenda një grupi. Për një cikel trajnimi mund të trajnohen dy (2) grupe.

3. Obligohet Institucioni që në afat kohor prej 3-6 muaj të plotësoj infrastrukturen e nevojshme për përsonat me aftësi të kufizuara përfshirë pjerrinen me pjerrtësi deri në 6 përqind, deren për qasje me gjërësi 1.10. metër dhe me kalueshmëri pa prag, ashensori nese është e nevojshme si edhe tualetet, po ashtu institucioni obligohet të ofroj dëshmi konkrete mbi zhvillimin e politikave dhe procedurave lidhur me vlerësimin e përsonave me aftësi të kufizuara.

4. Obligohet Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve të bëjë monitorimin lidhur me plotësimin e kushteve nga institucioni.

5. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A r s y e t i m

Instituti për Aftësim Profesional dhe Përkrahje të Punësimit "DITURIA", me datë 21.09.2023 ka parashtruar në AKK kërkesë për riakreditim dhe rivalidim të institucionit për kualifikimin: Muratorët dhe punëtorët e ngjashëm, niveli III i KKK, e cila është protokolluar dhe ka marrë numër 01/547. AKK bazuar në dispozitat ligjore në fuqi ka zhvilluar procedurat për vlerësim të institucionit sa i përket plotësimit të kritereve dhe standardeve të përcaktuara nga AKK.

AKK ka caktuar ekipin vlerësues të eksperteve për vlerësimin e institucionit. Ekipi i ekspertëve vlerësues ka shqyrtuar dokumentacionin e institucionit me datë 01.03.2024, vizitën tek aplikuesi e ka realizuar me datë 21.02.2024 për të bërë vlerësimin e institucionit lidhur me procesin e rivalidimit dhe riakreditimit, ndërsa pas analizimit të dosjes dhe realizimit të vizitës tek institucioni, ekipi i eksperteve me datë 19.03.2024 ka përpiluar raportin vlerësuese për riakreditim dhe rivalidim dhe ka dhënë vlerësim pozitiv për institucionin, të njëjtin ia rekomandoi Këshillit Drejtues të AKK-së për vendimmarrje. Institucioni mund të ofroj kualifikim jo të plotë të programi/kualifikimit për module. Me përfundimin e kualifikimit jo të plotë të programit/moduleve kandidatët mund të marrin certifikata të arritjeve.

Ekipi i ekspertve në raportin vlerësues ka dhën këto rekomandime për institucionin:

1. Rekomandohet qëndra që gjatë përpilimit të raportit të vetëvlerësimit dhe hartimit të dokumenteve tjera, të jenë të kyçur i gjithë stafi, ngase kjo rritë kualitetin e dokumentacionit dhe rregulloreve/procedurave/politikave të operimit të vet qendrës.

2. Rekomandohet qëndra që në vazhdimësi të përditësoj raportin e vetëvlerësimit duke reflektuar qartë gjendjen e qendrës dhe këtë ta pasqyroj tek notimi sipas formatit standard të AKK-së. Të identifikohen qartë përparësitë, mangësitë dhe nevojat që ka qendra.

3. Rekomandohet qendra që në vazhdimësi të përkrahë trajnimet dhe zhvillimin e stafit, duke qenë pro-aktiv në kërkesa dhe komunikim me institucionet përgjegjëse, nga të cilat ka varësi.

Rekomandimet përfundimtare të ekipeve të ekspertëve janë të mbështetura në dëshmi dhe dokumente të ofruara nga institucioni në fazën e aplikimit: Aplikacionin për riakreditim dhe rivalidim si institucion ofrues, vlerësues dhe certifikues i kualifikimit; Raportin e vetëvlerësimit;

Vizitën e ekipit të ekspertëve në Institutin për Aftësim Profesional dhe Përkrahje të Punësimit "Dituria" si dhe dokumente tjera shtesë.
Këshilli Drejtues pas analizimit dhe vlerësimit të raporteve vlerësuese të ekspertëve konstatoj se tek Pjesa 3 pika 1 raportit vlerësues për riakreditim infrastruktura e nevojshme për ofrim vlerësim dhe certifikim ekspertet nuk kanë ofruar dëshmi se institucioni plotëson standardet siç kërkohet në paragrafin 3 të këtij vendimi si dhe bazuar në nenin 10 paragrafi 1 pika 1.6 të Udhëzimit Administrativ (MASHT) Nr. 35/2014 Kriteret dhe Procedurat për Validimin dhe Aprovimin e Kualifikimeve Kombëtare dhe Akreditimin e Institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë.

Andaj, Këshilli Drejtues i AKK-së në bazë të kërkesës së "Institutin për Aftësim Profesional dhe Përkrahje të Punësimit "Dituria" për riakreditim dhe rivalidim, rekomandimeve përfundimtare të ekipit të ekspertëve të dhëna në raportin vlerësuese për riakreditim dhe rivalidim për institucionin aplikues si dhe nga të lartcekurat vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesa për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 20, pikat 1, 2, 3 dhe 4 të Udhëzimit Administrativ të MASHT për Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë me Nr. 35/2014. Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet KD të AKK, në afat prej 15 ditësh pas lëshimit të vendimit.

Vendimi u dërgohet:

1. IAPPP "DITURIA"
2. Arkivit të AKK-së.

Valmira Sejdiu

Nënkryetare e KD të AKK-së